

**PKR.nr1002/13**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA** – në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare e trupit, gjykatësve Beqir Kalludra dhe Lumnije Krasniqi si anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në çështjen penale sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore PP.nr.261/13 të dt: 08.10.2013, ndaj të akuzuarit A.B. për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së, dhe të akuzuarit P.K. për shkak të veprës penale Dhënja e ryshfetit nga neni 429 par.1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë, verbal e publik me dt: **12.04.2016** në prezencën e të akuzuarit A.B. me mbrojtësin av. B.E. sipas autorizimit, të njëjtën ditë bjenë e në prezencë të palëve publikisht shpallë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të akuzuarëve:

**A.B.** nga i ati A. dhe e ema Q. i vajzerise H., i lindur me *data e lindjes...* në P., ku dhe tani jeton, ka të kryer shkollën e lartë teknike, i martuar, baba 5 fëmijëve, i gjendjes të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Me nr. personal: *numër personal....*

**P.K.** nga i ati P. dhe e ema D., i vajzerise Gj., i lindur me *data e lindjes...* ne Gj., , me vendbanim në fshatin “N.” KK-Gj., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Me nr. personal: *numër personal....*

I akuzuari **A. B.**

**ËSHTË FAJTOR**

**I.SE**: në intervalin kohorë prej fundi të muajit dhjetor 2012, e deri me dt: 11.04.2013, në P., i pandehuri në cilësinë e personit zyrtar M., përgjegjës për m. e a. të KEK-ut, në mënyrë të vazhdueshme ka marr ryshfet nga tani i dëmtuari L.H. pronar i N.T.SH "E." e cila është marrë me shpërndarjen e rrjetit të internetit dhe rrjetit kabllovik në shumë prej 4.500.00 (katërmijë e pesëqind) euro, duke i premtuar se do ti ndihmoj për dhënien e licencës për shfrytëzimin e aseteve të KEK-ut, në atë mënyrë që: me dastën: 30.12.2012, janë takuar te banesat e bardha, në lagjen Bregu i Diellit në Prishtinë, dhe aty ipandehuri ka marr shumën prej 2,000.00 euro duke i premtuar të dëmtuarit se gjithsesi do të thirret për nënshkrimin e kontratës për lejimin e shfrytëzimit të aseteve të KEK-ut, për 6 fshatra në komunën e Prizrenit, ndërsa në bazë të kërkesës së të pandehurit me datë: 23.02.2013 janë takuar në parkingun e "B." në P. dhe aty i pandehuri kërkon shumën prej 2,000.00 (dymijë) euro që ti lejojë të dëmtuarit zgjerimin e rrjetit edhe për tri fshatra tjera, mirëpo i dëmtuari të pandehurit i jepë shumën prej 1,000.00 (njëmijë) euro, ndërsa për shumën prej 1,000.00 (njëmijë) euro dakordohen që të jepen në muajin prill me datën: 16.03.201, rreth orës 12:20 në parkingun e B. në P., i pandehuri merr nga tani i dëmtuari shumën prej 1,500.00 (njëmijë e pesëqind) euro nga shuma prej 5,000.00 (pesëmijë) euro të cilat i kishte kërkuar edhe për të pandehurin P. K., ndërsa shumën tejtër do ta merrte në muajin Prill me datë: 11.04.2013, në prakingun e restorantit "F." në P., takohen i pandehuri dhe i dëmtuari ku i pandehuri nga i dëmtuari merr shumën e parave prej 6,000.00 (gjashtëmijë) euro ku ndalet dhe arrestohet nga pjesëtarët e PK-së, dhe gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar parat e marrura pasi që ishte duke u zbatuar masa e fshehtë teknike e zbulimit dhe hetimit,

Me çka ka kryer në vazhdimësi veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së,

### **REFUZOHET AKUZA**

**II.SE**: Në muajin Janar të vitit 2012, në objektin e kompanisë 'K. N.' që gjendet në P., i pandehuri A. B., në cilësinë e M. për m. e a. të KEK-ut, ka ushtruar ndikim në drejtim të drejtorit menaxhues të kësaj kompanie V. P., në atë mënyrë që pasi ka kuptuar se në departamentin e finanacave është një vend i lirë për asistente, shumë herë ka shkuar në zyrën e të dëmtuarit, ka bërë presion për ndërrimin e shtyllave ka këputur kabllo e rrjetit me personin e ndërrimit të shtyllave derisa është punësuar vajza e tij F. B. në atë kompani,

Me çka kishte për të kryer veprën penale: ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së,

sepse prokurori i shtetit është tërhjek nga ndjekja penale për veprën penale në fjalë.

Ndaj të akuzuarit **P.K.**

### **REFUZOHET AKUZA**

**III.SE**: në mesin e muajit mars të vitit 2013, i pandehuri P.K.i ka dhënë ryshfet të pandehurit A. B., pasi që i pandehuri A.B. nëpërmes L. H. ka kërkuar shumën e parave

prej 5,000.00 (pesë mijë euro), me qëllim që t'i lejoj të pandehurit P. K., shfrytëzimin e aseteve të KEK-ut, duke shpërndarë rrjetin e interenetit nëpër shtyllat e KEK-ut, në fshatrat e Komunës së Gj., pasi që i pandehuri P.K. ishte pronar i N.T.SH "N.-N.", në atë mënyrë që: shokëve të tij Gj. H. dhe K. G., u jep 1,500.00 (njëmijë e pesëqind) euro në apoena 3x500 që t'ja dërgojë L. H., Gj. i fotografon të tri kartëmonedhat, me nr. serik X01010407547, X08471392931 dhe X06823363412 ja dërgojnë L. H. i cili me datë 16.03.2013 rreth orëse 12:20, në parkingun e B. në P. i jap të pandehurit A. B., këto kartëmonedha janë konfiskuar në shtëpinë e të pandehurit A. B.,-

-me çka kishte për të kryer veprën penale: Dhënia e Ryshfetit nga neni 429 par.1 të KPRK-së.

Sepse prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale për veprat penale në fjalë, ndaj të akuzuarëve të lartëshënuar.

Andaj gjykata në kuptim të neneve: 3,4,41,42,43,45,46,73,81 dhe 83 të KPRK-së, dhe neneve 363, 365, 450 ,463 të KPPRK-së.

Të akuzuarin **A.B.**

Për veprën penale: marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, e denon me **DENIM ME GJOBË** në shumën prej 2.000 (dymijë) euro, të cilën shumë i njejti është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe **DENIM ME BURG** në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajë, në të cilin llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data: 11.04.2013 deri me dt: 05.07.2013, dhe në arrest shtëpiak nga data: 05.07.2013 deri me dt. 05.08.2013.

Në rast se denimi me gjobë nuk mund të realizohet as me detyrim konform nenit 46 par.3 te KPPRK-së, gjykata këtë denim me gjobë do ta zavendësoi me denim burgu konform nenit 46 par. 3 te KPPK-se, ashtu qe gjdo 20 € ( euro) , të denimit të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim.

Të dëmtuarëve L. H. dhe P.K. do t'i kthehen të hollat, të cilat janë konfiskuar tek i akuzuari A.B. nga policija , sipas vërtetimit mbi marrjen e përkohshme të sendeve me nr te rastit 002-TF-2013 të dt: 11.04.2013, dhe atë L. H. shumën prej 3.000 € (tremijë euro), ndërsa P. K.shumën prej 1.500 € (njëmijë e pesëqind euro), në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Për veprën penale: Ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së, Konform nenit 363 par.1 nën.par.1.1 të KPPRK-së, mirret **AKTGJYKIM REFUZUES** sepse prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale për veprën penale në fjalë.

Ndaj të akuzuarit **P.K.** për veprën penale: Dhënia e Ryshfetit nga neni 429 par.1 të KPRK-së konform nenit 363 par.1 nën.par.1.1 të KPPRK-së mirret **AKTGJYKIM REFUZUES**, sepse prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale për veprën penale në fjalë.

I akuzuari **A.B.** obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej nga **200 € (dyqind) Euro**, në afat prej 15 (pesëmbëdhjet) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi. Ndërsa për **P.K.** shpenzimet e procedurës penale mbesin barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP.nr.261/13 të dt: 08.10.2013 ndaj të akuzuarëve: A.B. për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së, dhe P.K.për shkak të veprës penale Dhënja e ryshfetit nga neni 429 par.1 të KPRK-së.

Në këtë qështje penale juridike pasi që të akuzuarit janë njoftuar me të drejtat e tyre në kuptim të nenit 323 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarim shtesë, dhe pasi që ju ipet mundësia që të pranojnë ose mos ta e pranojnë fajësinë lidhur me veprat penale që ju vëhen në barrë, i akuzuari A.B. në seancën fillestare në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale Marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, që është precizuar në pikën 1 të dispozitivit të aktakuzës.

Pas deklarimit të akuzuarit A.B. se e pranon fajësinë për veprën penale nën pikën 1 të aktakuzës, të cilin pranim fajësie e ka bërë pas konsultave të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, me të cilin pranim fajësie është pajtuar edhe prokurori i shtetit, gjykata vlerësoi se janë përmbushur të gjitha kushtet nga neni 248 par.1 të KPPRK-së, pikërisht se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e qështjes që I përmbanë aktakuzën, në materialet e prezentuara nga prokuroria, të pranuar nga i akuzuari, prandaj gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit A. B., sepse janë përmbushur kushtet për pranimin e fajësisë nga neni 248 par.1 të KPPRK-së.

Gjykata i ka mbajtur shqyrtimet gjyqësorë duke i administruar të gjitha provat të propozuar nga ana e prokurorisë, sa i përket vepres penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së për të cilin akuzohet i akuzuari A.B. dhe veprës penale dhënja e ryshfetit nga neni 429 par.1 të KPK-së që i vëhet në barrë të akuzuarit P. K. , e që të dytë nuk i kanë pranuar fajësinë për këto vepra penale .

Në shqyrtimin gjyqësorë me datën 06.04.2016, prokurori i çështjes Ilaz Beqiri pas dëgjimit të dëmtuarit – dëshmitarit L.H., ka hjek dorë nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit A.B. për veprën penale të përshkruar në pikën 2 të dispozitivit të aktakuzës, ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së. poashtu ka hjek dorë nga ndjekja penale edhe ndaj të akuzuarit P. K. për veprën penale dhënja e ryshfetit nga neni 429 par.1 të KPRK-së, meqenëse me provat e administruara në shqyrtim gjyqësorë nuk është vërtetuar se i pandehuri A.B. ka kryer veprën penale si në pikën 2 të dispozitivit të

aktakuzës, e poashtu ndaj të akuzuarit P. K. konstatoj se është vërtetua se ky i akuzuar, ka bashkëpunuar me të dëmtuarin L. H. dhe ata kanë qenë në dijëni se rasti është i raportuar në polici.

Duke marr parasysh se prokurori i çështjes u tërhjek nga ndjekja penale ndaj të akuzuarëve A.B. për veprën penale të përshkruar në pikën 2 të dispozitivit të aktakuzës, dhe ndaj të akuzuarit P.K. për veprën penale nën pikën 3 të dispozitivit të aktakuzës, e poashtu duke marr parasysh se gjykata e ka miratuar pranimin e fajsisë, gjykata nuk ka vazhduar me deklarinimin e të akuzuarve, por konform nenit 326 par. 4 KPPRK-së. Shqyrtimin gjyqësorë ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i çështjes Ilaz Beqiri në fjalën përfundimtare në tërësi ka mbet pranë aktakuzës së ngritur si nën pikën 1 të dispozitivit me të cilin i pandehuri A. B. akuzohet për veprën penale në vazhdimësi Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, pasi që në shqyrtimin gjyqësorë u vërtetua se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale në kohë, vend dhe mënyrë e në vazhdimësi ashtu siq është edhe përshkruar në dispozitivin 1 të kësaj aktakuzë. Gjendja faktike u vërtetua me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili pranim i fajësisë është në përputhshmëri të plotë me të gjitha provat që gjinden në shkresat të lëndës. Në fund i ka propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallët fajtorë për këtë vepër penale dhe të gjykohet sipas ligjit, ku me rastin e matjes dhe përcaktimit të llojit dhe lartësisë së denimit, gjykata të merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë për këtë vepër penale. Poashtu ka mbetur pranë propozimit që shuma e parave prej 3.000 eurove të cilat janë sekuestruar në shtëpinë e A. B. të konfiskohen dhe të njëjtat t'i tkthehen të dëmtuarit L. H. e gjithashtu edhe shuma prej 1.500 euro t'i kthehet P. K., sipas shumës së konfiskuar prej 4.500 euro që janë gjetur në shtëpinë e të akuzuarit A. B..

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B. av.B. E., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se klienti i tij në shqyrtimin fillestarë ka pranuar fajësinë për veprën penale Marrja e ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, duke qenë i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, mirëpo edhe për benefitet që i ofron pranimi i fajësisë. E lut gjykatën që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së denimit të merr parasysh se rrethanë veqëanarisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga seanca fillestare, faktim se më parë nuk ka qenë i gjykuar dhe ndaj të njëjtit nuk zhvillohet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale. Pala e dëmtuar nuk ka kërkuar që të ndjeket penalisht, premtimin e tij se në të ardhmën nuk do të kryej vepra penale, që është mbajtës i familjës, është i penduar thellë për veprën për të cilën ka pranuar fajësinë, duke konsideruar se me një denim me kusht do të arrihet edhe qëllimi i paraparë konform nenit 41 të KPRK-së.

I akuzuari A.B. në tërësi e ka përkah fjalën përfundimtare të mbrojtësit dhe asgjë tejtër nuk kashtuar.

Duke marr parasysh se në seancën eshqyrtimit gjyqësorë të dt: 06.04.2016 prokurori i shtetit Ilaz Beqiri pas dëgjimit të dëshmitarit L. H. ka hjekë dorë nga ndjekja penale për të akuzuarin A.B. për veprën penale Ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së, por edhe ndaj të akuzuarit P.K.për veprën penale Dhënja e ryshfetit nga neni 429 par.1 të

KPK-së, nuk është e nevojshme që mbrojtësi i të akuzuarit P.K. av.N.Sh. edhe vet i akuzuari P.K. të paraqesin fjalën e tyre përfundimtare.

Me provat e ofruara, pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin 1 të aktgjyqimit. Nga provat të cilat janë propozuar dhe administruar si në aktakuzë, është vërtetuar se i akuzuari A.B. veprën penale për të cilën është shpallur fajtor e ka kryer me paramendim, sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta dhe e ka dashur kryerjen e sajë.

Gjatë procedurës penale, nuk janë paraqitur rrethanat të cilat do të zvogëlonin, apo përjashtonin përgjegjësinë penale e të akuzuarit, ashtu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë, gjykata gjeti se pranimi i fajësisë është i plotë dhe bindës dhe është në pajtim me provat e bashkangjitura në shkresat të lëndës, dhe gjeti se në veprimet e të akuzuarit A.B. manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të kryer në vazhdimësi Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Sa i përket veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së, të përshkruar si në pikën 2 të dispozitivit të aktakuzës, gjykata morri aktgjykim refuzues, meqenëse prokurori i çështjes gjatë shqyrtimit gjyqësorë e para fjalës përfundimtare, ka hjekë dorë nga ndjekja penale për veprën penale në fjalë.

Poashtu sa i përket veprës penale Dhënja e ryshfetit konform nenit 429 par.1 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit P. K., gjykata morri aktgjykim refuzues duke marr parasysh se prokurori i çështjes gjatë shqyrtimit gjyqësorë e para fjalës përfundimtare poashtu ka hjek dorë nga ndjekja penale për këtë të akuzuar për këtë vepër penale.

Gjatë matjes së denimit për të akuzuarin A.B. gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat letësuese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit konform nenit 73 të KPRK-së, si rrethanë letësuese e ka marr faktin se është i martuar, baba 5 fëmijëve, i gjendjes të mesme ekonomike, pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë për kryerjen e veprës penale dhe atë si rrethanë posaqërisht letësuese, kurse nga rrethanat rënduese ka marr mënyrën e kryerjes së veprës penale. Duke i vlerësuar në këtë mënyrë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kjo gjykatë ka vlerësuar se denimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjesisë penale të të akuzuarit, intezitetin e rrezikshmërisë shoqërore dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në arritjen e qëllimit të denimit, si masë për rehabilitimin dhe risocializimin e të akuzuarit, por edhe si masë për parandalimin e të akuzuarit dhe përsonave tjerë, kryes potencial të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata është e bindur se me denimin e shqiptuar në tërsi do të arihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenin 41 të KPRK-së.

Gjykata të akuzuarit i'a ka llogaritur tërë kohën të cilën i njejt i ka kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, konform nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Gjykata të akuzuarin e ka obliguar me pagimin e shpenzimeve të procedurës penale, pagimin e paushallit gjyqësorë konform nenit 450 par.2 nën.par.2.6 të KPPRK-së duke marr parasysh zgjatjen dhe nderlikueshmerine e procedurës penale dhe gjendjen materjale të akuzuarit, ndërsa për të akuzuarin P.K.454 par.1 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij atkgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR.nr.1002/13, të dt: 12.04.2016**

**Procesmbajtësi,**  
**Arianit Mahmutaj**

**Kryetarja e trupit - gjyqtarja,**  
**Shadije Gërguri**

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate